



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 173, datë 29.09.2023**

**PËR  
MIRATIMIN E AUDITUESIT “LIRENG AUDITING” SH.P.K., PËR AUDITIMIN E  
PASQYRAVE FINANCIARE TË “BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT”,  
PËR VITIN FINANCIAR QË MBYLLET MË 31.12.2023.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 32, datë 16.03.2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të rregullores nr. 37, datë 28.05.2015 “Për përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit” e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I :**

- 1. Miratimin e audituesit “Lireng Auditing” sh.p.k., për auditimin e pasqyrave financiare të “Byrosë Shqiptare të Sigurimit”, për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2023.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Zbatueshmërisë dhe Parandalimit të Pastrimit të Parave, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR  
Olsi ÇOKU**

**NËNDREJTOR EKZEKUTIV  
Mimoza KAÇI**